



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 69/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani, kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala anëtarë, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur në lidhje me parregullsi gjatë procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 13.01.2011, mori:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK),

ARSYETIMI

Më datë 10.01.2011 PZAP-i ka pranuar ankesë nga subjekti politik LDK në të cilën theksohet se “në QV në fshatrat Negroc, Orllat Llapushnik, Gllanasell, Korrotic e Eperme të komunes së Drenasit për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike në orën 16 e 30 min janë bërë manipulime të shumta në procesin e votimit, si rrjedhim kanë votuar persona të paidentifikuar dhe janë hedhur me tepër fletëvotime”.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk ka arritur të dëshmoj se është dëmtuar procesi i votimit si mungesë e energjisë elektrike ne vendvotimet perkatese, për më tepër pala ankuese nuk i ka bashkangjitur ankesës ndonjë provë materiale si dëshmi, që do të bënte të besueshme ekzistimin e shkeljes së pretenduar. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 69/2011 më datën 13.01.2011.

Kryesuesi i Panelit

